



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

“PARTNERITETI PËR QEVERINË E HAPUR” 2020 – 2022”

RAPORT PARA-KONSULTIMI

**Komponenti nr 3. “Aksesi në Drejtësi”
Hartimi i draft Planit të Veprimit**

PËRMBLEDHJE

Në Korrik 2020, Qeveria Shqiptare filloi procesin e hartimit të planit të veprimit OGP 2020-2022, në kuadër të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (këtu e tutje “PQH” ose “OGP”), si një ndër instrumentet më të rëndësishëm në nivel global, me qëllim nxitjen e transparencën qeveritare, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike, si dhe për të luftuar fenomenin e korrupsionit në të gjitha nivelet e ekspozimit të tij.

Ky proces, kryesohet nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri (DZHM), si struktura përgjegjëse e koordinimit për Partneritetin për Qeverisjen e Hapur në bashkëpunim me institucionet/strukturat përkatëse të OGP 2020-2022.

Plani i Veprimit 2020-2022 ka 4 komponentë kryesorë:

- i) Lufta kundër korrupsionit;
- ii) Qeverisja dixhitale;
- iii) Aksesi në Drejtësi;
- iv) Transparenca fiskale.¹

Qeverisja e Hapur për Aksesin në Drejtësi, përfshin gjithashtu transparencën dhe llogaridhënien. Ky komponent është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë me

¹ <http://ogp.gov.al/kategori/Konsultim-i-dokumentit-te-draft-planeve>

pikë fokale Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë (DPSFD).

I. KOMPONENTI Nr. 3 “AKSESI NË DREJTËSI”

Aksesi në drejtësi shihet si një nga komponentët kyç të qeverisë shqiptare e ndërlidhur fort me zbatimin e reformës në drejtësi, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND), Strategjinë Ndërsektoriale Antikorrupsion (SNKK), Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur (SDM), Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), si dhe masat e tjera të ndërmarra nga Qeveria në përmbushje të misionit të saj për një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënese.

Për më tepër, aksesin në drejtësi vlerësohet si një nga parimet kryesore të sundimit të ligjit. UNDP e ka përcaktuar aksesin në drejtësi si “mundësia e qytetarëve për të kërkuar dhe siguruar një mjet juridik përmes institucioneve formale apo jo formale të drejtësisë, dhe në përputhje me standartet themelore të të drejtave të njeriut” (2005). Kombet e Bashkuara nga ana tjetër, në Pikën 16 të Qëllimeve Të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG Agjenda 2030) synon: *Promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimin e aksesit në drejtësi për të gjithë, dhe ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.*

Ministria e Drejtësisë në përmbushje të misionit dhe funksionit të saj, ka ndërmarrë me sukses realizimin e iniciativave të domosdoshme dhe masave të propozuara në SND dhe SNKK, sidomos ato që lidhen direkt me aksesin në drejtësi. Në këtë kuadër, është ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (aksesi në drejtësi) dhe Drejtoria Antikorrupsion (transparencë dhe llogaridhënie).

Objektivi i Politikës kryesore dhe Objektivave Specifikë:

1. Politika Kryesore

Politika e Komponentit nr 3. “Aksesi në Drejtësi” është propozuar si:

Ndërtimi i një qeverie të hapur që i siguron qytetarëve të saj akses në drejtësi, transparencë dhe llogaridhënie.

2. Objektivat Specifikë

Objektivat specifikë në përmbushje të politikës kryesore, janë propozuar si vijon:

- 1) Aksesi në drejtësi është i garantuar dhe është në përputhje me ligjet kombëtare, si dhe standartet evropiane dhe praktikat më të mira.*
- 2) Funksionimi dhe kapacitetet e Ministrisë së Drejtësisë janë forcuar në fushat e transparencës dhe llogaridhënies.*

Politika kryesore e aksesit në drejtësi, e formuluar më së miri dhe e qartë, mundëson përcaktimin e drejtë të objektivave specifikë dhe adoptimin e masave konkrete dhe të realizueshme në përmbushje të saj, përfshirë pasaportën e indikatorëve. Për çdo objektiv specifik janë propozuar tre masa prioritare si dhe aktivitete që i korrespondojnë çdo mase të cilat mund të amendohen pas konsultimit me grupet e interesit. Sipas fushës së veprimit dhe përgjegjësisë, Ministria e Drejtësisë është institucion përgjegjës ose në bashkëpunim me institucione të tjera.

Aksesi në drejtësi nuk mund të shihet i realizuar dhe në përputhje me parimin e sundimit të ligjit nëse ai nuk është transparent dhe llogaridhënës. Si rrjedhojë, si transparanca ashtu dhe llogaridhënia janë përfshirë në draftin e planit të veprimit me objektiva specifikë dhe masa konkrete. Të treja elementët të zbatuara në konform me ligjin, të ndërthurrura në zbatimin e masave të tyre, mundësojnë realizimin me sukses të kësaj të drejte themelore universale të qytetarëve në një shoqëri demokratike.

3. Sfidat e deritanishme

Mungesa e kapaciteteve të nevojshme (buxhetore, strukturale, njerëzore) kanë qënë disa nga pengesat në mungesën e aksesit të plotë në drejtësi. Nga ana tjetër, OGP dhe Independent Reporting Mechanism (IRM) pas vlerësimit/monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit (PV) 2018-2020 konkluduan se “*Shqipëria veprimi jo në linjën e duhur të procesit të OGP pasi spektrum i pjesëmarrjes nga shoqëria civile dhe forumet e dedikuara me pjesëmarrjen e tyre, nuk u përmbushën siç duhej*”.

Përsa më lartë, ndërthurja e mungesës së kapaciteteve dhe lënia jashtë procesit të shoqërisë civile dhe asaj akademike, kontributi i të cilëve është mjaft i domosdoshëm, do të mundësojnë realizimin e kësaj politike kryesore për plotësimin e kushteve dhe standarteve për një qeverisje të hapur në partneritet me të gjitha grupet e interesit.

Duke patur parasysh rekomandimet e IRM në lidhje me PV 2018-2020, metodologjia e PV 2020-2022 ndryshoi dhe procesi i miratimit të Planeve të Veprimit për secilin komponent të OGP 2020-2022 do të konsultohet me grupet e interesit në disa tryeza konsultimi.

II. METODOLOGJIA

1. Formulimi i Sondazhit

OGP i jep prioritet transparencës dhe aksesit në qeverisje. Sipas standarteve të OGP, metodologjia e duhur për një qeverisje të hapur bazohet në një proces gjithëpërfshirës, të drejtë dhe transparent me të gjitha grupet e interesit. Duke patur parasysh konkluzionet e arritura nga vlerësimi dhe monitorimi i IRM për OGP 2018-2020, i cili i rekomandoi qeverisë shqiptare *të prioritzojë pjesëmarrjen e grupeve të interesit në proces si dhe standardet e adoptuara nga OGP për këtë qëllim, si dhe krijimin e një forumi të dedikuar të grupeve të interesit të përzgjedhur sipas kriterëve transparente dhe të qarta*, procesi i ndërmarrë nga DPSFD deri në momentin e këtij raporti, ka kaluar këto faza:

- Përcaktimi i listës së shoqërisë civile, akademisë dhe profesionistëve juristë (“grupeve të interesit”) të cilët kanë një eksperiencë të dobishme në fushën e drejtësisë (lista bashkangjitur si Aneks 1).
- Draftimi i Planit të Veprimit të Komponentit të Aksesit në Drejtësi (përfshirë politikën kryesore, objektivat specifike, masat/aktivitetet në përmbushje të këtyre objektiveve)².
- Hartimi i pyetësorit, i cili u konsultua me ekspertin e angazhuar nga DZHM.
- Informimi elektronik i grupeve të interesit mbi draftin e PV 2020-2022 (Aksesi në Drejtësi) dhe pyetësin.

² Drafti i Planit të Veprimit gjendet në këtë link: <http://ogp.gov.al/artikull/komponenti-3-drejttesi>

- Analizimi i të përgjigjeve të marra lidhur me pyëtsorin, mbi bazën e të cilave do të hartohen përfundimisht objektivat specifike dhe masat/aktivitetet në përmbushje të politikës kryesore.
- Plotësim i Tabelës “Prioritization Matrix” i cili do të ndahet me grupet e interesit së bashku me këtë raport në takime konsultative.

2. Zgjedhja e grupeve të interesit

Ministria e Drejtësisë, për shkak të funksionit të saj si dhe shumë projekteve të ndërmarra në fushën e drejtësisë ka përfshirë një gamë të gjerë të shoqërive civile, qendrave studimore, botës akademike dhe juristëve të shquar. Si rrjedhojë, për këtë proces ashtu si për projektet e tjera në fushën e drejtësisë, u përdor lista e shoqërive civile/grupeve të interesit të cilat kanë lidhje direkte ose indirekte me aksesin në drejtësi, transparencën dhe llogaridhënien institucionale. Për shembull, lista e grupeve të interesit, përfshin: shoqatat civile që kanë lidhje direkte me sistemin e drejtësisë dhe prekin tema të ndryshme sociale-ekonomike si, ndihma ligjore për gratë dhe femijët apo grupet vulnerable, ndihma ligjore për rastet e dhunës në familje, shoqatat në ndihmë të minoriteteve dhe imigrantëve. Gjithashtu, janë përfshirë fakultetet e drejtësisë së universiteteve shtetëror dhe privatë si dhe akademik/profesor që ushtrojnë veprimtarinë e tyre me lidhje direkte në sistemin ligjor si dhe qendra studimore dhe shoqata që merren me vëzhgimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore me synin kërkimin e llogaridhënies nga ana e qeverisë.

Kjo përzgjedhje e grupeve të interesit ndihmon në realizimin me sukses të këtij komponenti duke filluar që nga faza konsultative deri në përfundim të tij.

III. GJETJET/REZULTATET E SONDAZHIT

Pyetësori u plotësua nga 11 grupe të interesuara. Përgjigjet e marra nga sondazhi (Gusht-Shtator 2020) janë bashkëngjitur si Aneks 2. U hartuan 14 pyetje dhe 12 nën-pyetje, në total 26. Pyetjet u bazuan në rolin dhe funksionin e MD-së sipas *Ligjit nr. 8678 datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”*, të ndryshuar, si dhe në përmbushje të detyrave dhe misionit të saj.

1. Gjetjet e Sondazhit

Nga analiza e kryer e pyetjeve rezulton se:

Pyetja 1, 1.1 dhe 1.2:

Rreth 64% e përdorin faqen e MD-së për të marrë informacion dhe ka vend për përmirësim në informacionin e publikuar dhe aksesueshmërinë, sidomos në lidhje me transparencën e shpenzimeve/buxhetit. Një përgjigje në veçanti citon se pavarësisht se ekziston një dritare për buxhetin, informacioni i publikuar nuk është shumë transparent për çdo shpenzim të kryer nga institucioni.

Pyetja 2 dhe 2.1:

Kjo pyetje ka të bëjë me informacionin e dhënë nga MD-ja në lidhje me këshilla/ndihmë ligjore që qytetarët mund të identifikojnë në ëbsitin e saj. Në përgjithësi është dhënë mendim pozitiv (70%) por ka vend për përmirësime sidomos në fusha të caktuara si arbitrazhi, mjekësia ligjore dhe sugjerohet të krijohet rubrikë e veçantë për qytetarët për të gjitha ndihmat që mund të japë MD-ja në rast nevojë sidomos për ata që nuk mund të kenë akses online.

Pyetja 3 dhe 3.1:

Kjo pyetje lidhet me punën që bën MD-ja për aksesin në drejtësi. Vlerësohet jo e mjaftueshme puna e Ministrisë dhe si pengesë shihen disa faktorë: krimi, informacion i pamjaftueshëm, burokracia, mungesa e gjykatave, njohja e pakët e ligjit nga qytetarët etj.

Pyetja 4, 4.1 dhe 4.2:

Kjo lidhet me punën që bën MD-ja për transparencën dhe llogaridhënien; ka përgjigje pozitive ku rreth 64% mendojnë se bëhet një punë e mirë. Megjithatë shihet e domosdoshme rritja e transparencës së informacionit jo vetëm për të drejtat e qytetarëve por dhe për çfarë bën MD-ja në veprimtarinë e saj sidomos me buxhetin dhe vendimmarrjen.

Pyetja 5:

Kjo lidhet me ofrimin e ndihmës juridike falas dhe nëse kjo ndihmë është e mjaftueshme nga MD-ja. Përgjigja është në përgjithësi pozitive por ka vend për përmirësim pasi mbi 35% mendojnë që nuk është e mjaftueshme dhe duhet bërë më tepër.

Pyetja 6 dhe 6.1:

Ka të bëjë me funksionimin e ndërmjetësimit për çështjet juridike. Rreth 45% mendojnë se puna nuk është shumë pozitive dhe ka nevojë për përmirësim sidomos në lidhje me mungesën e ndërgjegjësimit të qytetarëve për ndërmjetësim, mungesën e bashkëpunimit midis MD-së dhe universiteteve, si dhe ecurinë e reformës në drejtësi.

Pyetja 7 dhe 7.1:

Pyetja është shumë direkte dhe kërkon mendim nëse MD-ja i zgjidh çështjet e drejtësisë në mënyrë të drejtë. Pothuajse gjysma mendon që jo, dhe në zgjerimin e përgjigjeve ka mendim pozitiv por dhe negativ. Pavarësisht se kjo pyetje është shumë specifike dhe ka qënë në diskutim për t'u përfshirë apo jo, u vendos përfshirja për të marrë një mendim të drejtëpërdrejtë se çfarë mendojnë grupet e interesuara në këtë aspekt.

Pyetja 8 dhe 9:

Kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjeve në kohën e duhur dhe nëse vonesa dekurajon aksesin në drejtësi. Përgjigjet janë negative në përgjithësi dhe janë dakort që vonesa dekurajon qytetarët në kërkimin e të drejtave të tyre. Pra, përshpejtimi i zgjidhjeve të çështjeve shihet si domodsoshmëri.

Pyetja 10, 10.1 dhe 10.2:

Kjo ka të bëjë me Drejtorinë e Burgjeve dhe ka mendime negative. Kërkohet përmirësim sidomos me Institutin e Mjekësisë Ligjore, të dënuarit të sëmurë, rritja e kapaciteteve të institucioneve të rehabilitimit etj.

Pyetja 11, 11.1 dhe 11.2:

Kjo pyetje ka të bëjë me përmbauesit ligjorë dhe noterët (proçesin i liçensimit, funksionimit, kontrollit etj.) Kërkohet përmirësim nga MD-ja në këtë sektor. Kërkohet në veçanti, përmirësimi i mekanizmave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, trajnimi i noterëve dhe përmbauesve, rritja e kontrollit të punës së tyre, funksionimi i plotë i dixhitalizimit të sistemit noterial dhe përmbarimor.

Pyetja 12:

U kërkohet grupeve të interesit mendim, se ku duhet të përqëndrohet puna e MD-së për sigurimin e aksesit, transparencës dhe llogaridhënies. Sugjerohet kontrolle në institucionet e varësisë, përfshirjen e shoqërisë civile në proçes, transparencë sidomos me shpenzimet buxhetore, rritjen e shërbimeve ndaj

qytetarëve sipas nevojave dhe uljen e kohës së procesit ndaj kërkesave të qytetarëve.

Pyetja 13:

U kërkon mendim se çfarë masash prioritare sugjerohen për përmirësim të aksesit në drejtësi? Sugjerohen fushata informuese, sidomos për dixhitalizimin e shërbimeve, krijimin e mekanizmave më të thjeshtë dhe jo burokratike për ndihmën e kërkuar, si dhe publikime të çdo lloj informacioni.

Pyetja 14:

Kjo pyetje kërkon mendim se si mund të përmirësohet aksesit, transparenca dhe llogaridhënia. Sugjerohet sukcesi dhe përshtetimi i reformës në drejtësi, ndarjen e politikës nga sistemi i drejtësisë, përfshirjen e shoqërisë civile në procese konsultimi dhe vendimmarrje, akses të qytetarëve në seanca gjyqësore.

2. Konkluzione mbi rezultatet e pyetësorit

Pjesëmarrësit në sondazh, në terma të përgjithshme e vlerësojnë punën e MD-së në aspekte pozitive, por vënë në dukje fushat kur duhet të përqëndrohet përmirësimi. Sipas përgjigjeve, *shihet e nevojshme për t'u përmirësuar më shumë transparenca sesa aksesit apo llogaridhënia*. Pra, transparenca kërkohet në publikimin e çdo lloj informacioni, sidomos ato informacione që kanë të bëjnë me shpenzimet/buxhetin dhe vendimmarrjen nga ana e institucionit.

Përmirësimet konkrete sugjerohen si vijon:

- Të jepet më shumë informacion i plotë dhe i detajuar në faqen e MD-së;
- Të rritet transparenca sidomos përsa i përket shpenzimeve/buxhetit nga institucioni dhe çdo vendimarrje tjetër në përmbushje të rolit dhe funksionit të saj;
- Funksionimin e plotë dixhital të sistemeve elektronike kryesisht të noterisë, përmbaruesve por dhe institucioneve të tjera të varësisë;
- Rritjen e kapaciteteve të Drejtorisë së Burgjeve, Institutit të Mjekësisë Ligjore si dhe Sistemit të Rehabilitimit;
- Funksionimin e plotë të ndërmjetësimit për zgjidhjen e çështjeve ligjore;
- Rritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe universitetet;
- Rritja e efikasitetit në dhënien e përgjigjeve qytetarëve dhe zgjidhjen e problemeve që ngrihen në ankesat e tyre, si rrjedhojë uljen e burokracisë në sistemin e drejtësisë;

- Përshpejtimi dhe funksionimi i reformës në drejtësi i cili do ndikojë pozitivisht në shumë aspekte të ngritura si shqetësime nga grupet e interesit.

IV. MANGËSI/REAGIME TË PARAGJYKUESHME/NJËANSHME

1. Paragjykime (biases)

Ministria e Drejtësisë vlerëson dhe mirëpret çdo koment dhe sugjerim të mundshëm nga shoqëria civile. Për më tepër, një nga arsyet që ky proces kalon faza konsultimi është pikërisht përfshirja e grupeve të interesit në mënyrë që qeveria të përmbushë detyrimet e saj ligjore në një shoqëri demokratike.

OGP 2020-2022 vjen në rrjedhën e realizimit të objektivave të qeverisë duke filluar që nga viti 2012 me adoptimin e PV 2012-2014 dhe më pas me tre plane të tjera konsektive të cilat prekën komponente kyçe të veprimtarisë së qeverisë shqiptare.

Ndodh që një komponent të jetë përsëritës nga një plan veprimi në tjetrin. Nëse objektivat e një komponenti dhe masat/projektet e lidhura me të mund të jenë bërë më parë ose kanë ngjashmëri me planet e veprimeve të mëparshme, nuk do të thotë që rezultati të jetë i njëjtë. Kjo për shumë arsye. E para, sepse vetë rrethanat politike, sociale, demografike, ligjore, etj., kanë ndikime të ndryshme në kohë të ndryshme të zbatimit të tyre. E dyta, kapacitetet njerëzore dhe ato infrastrukturore, nuk mund të jenë të njëjta, si rrjedhojë aplikimet e tyre nuk sjellin të njëjtat rezultate. E treta, gjithmonë ka vend për përmirësim. Pra një objektiv specifik/masë që është kryer në një kohë të caktuar mund të përmirësohet më tej dhe rezultatet do jenë më të kënaqshme dhe efekti pozitiv i tyre do të jetë afatgjat.

Përsa i përket komponentit Akses në Drejtësi, pavarësisht se angazhimi ishte jo shumë i lartë në plotësimin e pyetësorit dhe ne nuk mund të dimë arsyet për këtë mospërfshirje dhe nëse mospërfshirja është për shkak njëanshmërie apo paragjykimesh me iniciativat e ndërrmara nga ana e qeverisë, jemi të mendimit se identifikimi i mënyrave dhe mjeteve për përfshirje në proces që në fazën e pyetësorit dhe në vazhdim, do të ndikojë në përmirësimin e procesit të përfshirjes dhe shmangjes së paragjykimeve apo njëanshmërisë.

2. Mungesa e përfshirjes në sondazh

Rreth 10% e grupeve të interesuara iu përgjigjën pyetësorit. Një arsye mund të jetë koha gjatë të cilit pyetësi u draftua dhe u publikua në web (muajin Gusht kur shumica janë me pushim). Një arsye tjetër mund të jetë numri i pyetjeve të tij (14 pyetje dhe 12 nënpyetje). Disa pyetje janë përgjigjur me “nuk kam informacion”. Kjo për arsye të shumë faktorëve. Shumë grupe të interesuara nuk i lidh puna direkt me Ministrinë e Drejtësisë për sa i përket aksesit të informacionit që publikon MD-ja, pavarësisht se janë pjesëtarë të shoqërisë civile apo akademikë dhe nuk ndihen komodë të japin një përgjigje kur nuk kanë informacion të plotë në lidhje me pyetjen.

V. PËRGATITJA E FAZËS SË ARDHSHME

Do të kryhen takime konsultative me grupet e interesit. Takimi i parë do të bëhet më datë 29 Shtator e takimet e tjera do të organizohen gjatë muajit Tetor. Në takime do të diskutohen nëse objektivat specifike dhe masat përkatëse janë të plota apo kanë nevojë për ndryshime si dhe institucionet që do të jenë përgjegjëse për çdo masë. Grupeve të interesit do tu shpërndahet gjithashtu Tabela e Prioriteteve (Prioritization Matrix Template) sipas të cilës do të vendosen se cilat objektiva/masa kanë prioritet për tu realizuar sipas rëndësisë dhe ndikimit të qytetarët dhe cilat do të kenë më shumë peshë për një ndikim pozitiv në tre elementet: akses, transparencë dhe llogaridhënie.

Në takimet që do të zhvillohen, do të vihet theksi te përfshirja e grupeve të interesit, sugjerimet dhe komentet e tyre për këtë komponent. Format e kontaktit do të jenë nëpërmjet email-it, telefonatave dhe takimeve konsultative.

Pas konsultimeve, drafti përfundimtar i Planit të Veprimit do të miratohet dhe do të fillojë puna për zbatimin e tij në bashkëpunim me institucionet sipas masave.

Aneks 1: Lista e Grupeve të Interesuara

Emër Mbiemër	Sektori	Institucioni	Pozicioni	E-mail
Gledis Gjepali	OJF	Ema-European Movement Albania	Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes Europiane	gledis.gjepali@em-al.org
Aldo Merkoci	OJF	Lëvizja MJAFT!	Drejtor Ekzekutiv	aldo.merkoci@mjaft
Kol Nikollaj	Organizatë Sindikale	Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë	President i KSSH	president@kssh.org
Dritan Shutina	OJF	Co- PLAN	Drejtor Ekzekutiv	co-plan@co-plan.org
Bledar Taho	OJF	Instituti of Romani Culture of Albania	Drejtor i Përgjithshëm	institute.irca@gmail.com
Mihail Dimovski	Entitet Ligjor	Qendra Rajonale e Mjedisit	Drejtor Ekzekutiv	rec.albania@rec.org
Edlira Cepani	OJF	Barazi në rrjetin e vendimarrjes	Koordinatorë Kombëtare	edliracepani@yahoo.com
Andi Dobrush	Fondacion	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë	Drejtor Ekzekutiv	klodjan.Seferaj@osfa.al
Juliana Hoxha	OJF	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Drejtor Ekzekutiv	partners@partnersalbania.org
Remzi Lani	OJF	Ami-Albanian Media Institute	Drejtor Ekzekutiv	rlani@institutemedia.org
Alba Cela	OJF	Albanian Institute for International Studies (AIIS)	Drejtor Ekzekutiv	arakipi@aiis-albania.org
Ilir Gadeshi	OJF	Centre For Economic and Social Studies	Drejtor Ekzekutiv	gadeshi@hotmail.com
Elira Jorgoni	OJF	The Future of the Welfare State	Drejtor Ekzekutiv	elira.jorgoni@gmail.com
Albana Dhimitri	OJF	Instituti I Politikave Publike dhe Private	Drejtor Ekzekutiv	info@institutip3.com
Artan Hoxha	Akademi	Universiteti i Tiranës	Rektor	hoxha.artan@gmail.com
Edlir Vokopola	OJF	Instituti i Kërkimeve Urbane	Drejtor Ekzekutiv	zvokopola@uri.org.al
Gentian Elezi	OJF	Institui AGENDA	Drejtor Ekzekutiv	info@agendainstitute.org

Krisela Hackaj	OJF	Cooperation&Development Institute	Drejtor Ekzekutiv	Ardian.hackaj@cdinstitute.eu
EURONA LEKA	OJF	Instituti Shqipëtar Për Cështjet Publike	Drejtor Ekzekutiv	director.aipa@umb.edu.al
Ina Xhepa	OJF	European Centre	Drejtor Ekzekutiv	inaxhepa@euro-centre.eu
Eda Nocka	OJF	Qendra Altri	Drejtor Ekzekutiv	qendra.altri@gmail.com
Naureda Bajraktari	OJF	Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integuara	Drejtor Ekzekutiv	nauredabajraktari@gmail.com
Erida Skëndaj	OJF	Komiteti Shqiptar I Helsinkit	Drejtor Ekzekutiv	erida.skendaj@ahc.org.al
Edmond Stojku	OJF	Albanian Life Quality Union	Drejtor Ekzekutiv	info@al-qu.com
Ina Goxhaj	OJF	Balkan Youth Link Albania	Drejtor Ekzekutiv	balkanyouthlink@live.com
Juliana Hoxha	OJF	The Albanian Crowd	Drejtor Ekzekutiv	qendraeuropianeinfo@gmail.com
Altin Hazizaj	OJF	Children's Human Rights Center of Albania	Drejtor Ekzekutiv	altin.hazizaj@crca.al ;
Hysen Vathi	OJF	Qendra për Ndihmë, Rehabilitim dhe Integrim (QNRI)	Drejtor Ekzekutiv	qnri_info@yahoo.com
Kristaq Birbo	OJF	Atlantic Council of Albania	Drejtor Ekzekutiv	atca@albaniaonline.net
Andi Haxhillari	OJF	Shoqata Humanitare Kuka	Ideator dhe Themelues	hysni.kuka@yahoo.com
Sotiraj Hroni	OJF	Institute For Democracy and Mediation	Drejtor Ekzekutiv	info@idmalbania.org
Gjon Gaspri	OJF	Albanian Agrobussines Council	Drejtor Ekzekutiv	gjongaspri@yahoo.com
Gerta Meta	OJF	Shoqata për Kulturë Demokratike	Drejtor Ekzekutiv	gertameta@yahoo.com
Fred Westerink	OJF	Prison Fellowship Albania	Drejtor Ekzekutiv	reception@shkbsh.com
Ilir Aliaj	OJF	Centre For Development and Democratization of Institutions (CDDI)	Drejtor Ekzekutiv	ilir.aliaj@qzhdi-alb.org
Adela Bucpapaj	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	adela.bucpapaj@hotmail.com
Arben Shehu	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	arbenlshedu@yahoo.it


Aurela Anastasi	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	aurela_anast@yahoo.com
Engjell Likmeta	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	likmetaengjell@hotmail.com
Eniana Qarri	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	eniana-qarri@hotmail.com
Eneida Sema	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	eneidasema@yahoo.com
Illir Rusi	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	ilirusi@yahoo.com
Iva Konomi	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	iva_konini@hotmail.com
Jola Xhafo	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	xhafojola@yahoo.com
Kestrin Katro	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	kestrin2002@yahoo.it
Zhaklin Peto	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	zhaklinpeto@gmail.com
Klesta Hysi	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	klesta.hysi@gmail.com
Klodjan Skënderaj	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	klodjans@gmail.com
Laura Vorpsi	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	laura.vorpsi@yahoo.com
Lirime Cukaj	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	lilicukaj@yahoo.it
Luljeta Ikonomi	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	likonomi2000@yahoo.com
Besnik Cerekja	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	besnik.cerekja@gmail.com
Sokol Mëngjesi	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	smengjesi@yahoo.com
Dorina Hoxha	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	dohory@yahoo.it
Erlir Puto	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	erlirputo@gmail.com ;
Jonida Rustemaj	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	jrustemaj@gmail.com
Kreshnik Myftari	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	kreshnik_myftari@hotmail.com
Mirela Bogdani	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	mirelbogdani@gmail.com
Fabian Topollaj	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	fabiantopollari@gmail.com
Artill Imando	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	artilimandro@gmail.com

Fjorda Shqarri	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	fjorda.shqarri@hotmail.com
Eriona Katro	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	erionakatro@yahoo.it
Kristina Jance	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	k.jance@yahoo.it
Erida Pejo	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	eridapejo@gmail.com
Kristaq Gjyli	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	k.gjyli@gmail.com
Ardian Nuni	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	ardian_nuni@yahoo.com
Ilda Melo	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	ildamelo@yahoo.com
Anisa Angjeli	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	anisaangjeli@gmail.com
Iv Rokaj	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	iv_rokaj@yahoo.com
Skerdian Kurti	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	skerdiankurti@yahoo.it
Henris Balliu	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	henrisballiu@gmail.com
Enkelejda Boci	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	enkelejdeboci@gmail.com
Iva Zajmi	Akademi	Fakulteti i Drejtësisë	Pedagog	iva_zajmi@yahoo.com
Tom Malvet	OJF	SOS Fshatrat e Fëmijëve	Drejtor Ekzekutiv	teuta.shkenza@soskd.org.al
Suela Koçibellin	OJF	Vizion OJF	Drejtor Ekzekutiv	info@vizionojf.org
Shega Murati	OJF	Euro Partners Development	Drejtor Ekzekutiv	shega_murati@yahoo.com
Eni Rika	OJF	Shoqata Internacionale për Solidaritetin	President	e.rika@shisalbania.org ;
Mrike Cara	OJF	Shoqata Për Integrimin e Zonave E Informale	Drejtor Ekzekutiv	mrikkara@hotmail.com
Arian Boci	OJF	Shoqata “Për Progres dhe Civilizim”	Drejtor Ekzekutiv	pcivilizim@yahoo.com
Art Boshnjaku	OJF	Art, Edukim & Promovim	Drejtor Ekzekutiv	boshnjakuart@gmail.com
Iris Luarasi	OJF	Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza	Drejtor Ekzekutiv	linjakeshillimit@gmail.com
Andi Dobrushit	OJF	Fondacioni Shoqëria e Hapur Për Shqipërinë	Drejtor Ekzekutiv	cps@albaniaonline.net
Zela Koka	OJF	Mbrojtje e Personave me Aftësi të Kufizuara	Drejtor Ekzekutiv	info@medpak.org

Josef Azizi	OJF	Qendra L.I.S.T.	Drejtor Ekzekutiv	gendralist@gmail.com
Jonida Mamaj	OJF	Qendra Eden	Drejtor Ekzekutiv	eden@eden-al.org
Ermelinda Mahmutaj	OJF	Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim	Drejtor Ekzekutiv	ermelinda.mahmutaj@eden-al.org
Jolanda Trebicka	OJF	Euro Partners Development	Drejtor Ekzekutiv	europartners@europartners.al
Albert Rakipi	OJF	Albanian Institute For International Studies	Drejtor Ekzekutiv	aiis@aiis-albania.org
Marinela Sota	Akademi	Fakulteti "Aleksandër Xhuvani"	Pedagog	sotamarinela@yahoo.com

Aneks 2: Përmbledhje/analizë e përgjigjeve të Sondazhit³

Pyetja 1



3. <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSeHm-pIWM-lwCiEAHZ9Q3sVOuEPWquiFh6h4SyJ7xymK07-qQ/viewanalytics>

Nën-pyetja 1.1.

1.1 Nëse po, a mendoni se informacioni i publikuar është i plotë dhe i qartë? Ju lutemi argumentoni mendimin tuaj.

6 responses

Snume i qarte dhe i plote.

Per informacione te vecanta, informohemi nepermjet web faqes se MD, por gjithsesi ka vend per plotesim.

Kryesisht, e vizitoj faqen e ministrisë për të aksesuar dokumenta që lidhen me transparencën institucionale. Përgjithësisht, informacioni i parashikuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ka një hapësirë të dedikuar në webpage, por nuk është i plotë. Ekzaktësisht, informacioni për buxhetin, edhe pse ekziston një dritare e dedikuar, është shumë i paktën dhe mungon informacioni për shpenzimet faktike. Nga komunikimet e mëparshme, referohet gjithmonë Ministria e Financave për shpenzimet e institucione, por po t'i referohemi rekomandimeve të EU për një qeveri transparente dhe të hapur, të dhëna të tilla do duhet të jenë të aksesueshme në secilën faqen online të secilit institucion.

Po sepse çdo informacion i nxjerr nga Ministria e Drejtësisë është i saktë dhe postohet në kohe.

Ndonjehere por mund te jete edhe me funksional

Nën-pyetja 1.2.

1.2 Nëse jo, a ka ndonjë arsye që nuk e përdorni faqen në internet dhe si i merrni informacionet ndryshe?

6 responses

Nuk mundeson shume informacione.

Informacioni nuk eshte lehtesisht i aksesueshem.

-

Lajme, gazeta,


Jo gjithmon lajmin me te shpejte mund ta gjesh tek faqja e Ministrise ne internet

E marrim informacionin nga burime te tjera

Pyetja 2

2. A ofron Ministria e Drejtësisë informacion të mjaftueshëm, për të mundësuar individëve të identifikojnë nevojat e tyre ligjore, të identifikojnë burimet e këshillave juridike dhe të identifikojnë se si të kërkojnë drejtësi?

10 responses



Nën-pyetja 2.1

Pyetja 3 dhe Nën-pyetja 3.1

2.1 Ju lutemi shtjelloni ndonjë çështje specifike ose rekomandime që mund të keni për aksesin gjithnjë e më të madh për informacionin për qytetarët

6 responses

Ekspertet pisikiater ligjor qe duan te licensohen duhet te kete nje rubrike specifike sepse nuk jane mjek ligjore ndryshon profili.

Duhet me shume kontroll dhe raportime periodike ne lidhje me aspekte te ndryshme mbi drejtesine. Per shembull duhet me shume informacion mbi arbitrazhin.

Të krijohet një hapësirë e dukshme në homepage, ku të përmblihet dhe strukturohet informacioni me interes qytetar. Gjithashtu, krahas kërkesave fizike për informacion, të organizohet në mënyrë funksionale komunikimi online për informacion publik ndërmjet institucionit dhe qytetarëve që përdorin faqen online të ministrisë.


Mbase në televizion ose ne rrjete sociale.

Me shume informacione praktike per tu kuptuae dhe nga qytetaret e thjeshte te cilet nuk kane mjaftueshem informacion dhe e shohin si burimin e vetem

Qytetaret vazhdojne e preferojne kontaknin e drejteperdrejte per te marre informacion

3. Si e vlerësoni punën e bërë nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me aksesin e qytetarëve në drejtësi?

11 responses



3.1 Cfarë vlerësoni si pengesën më të madhe për aksesin e qytetarëve në drejtësi?

7 responses

Qeverine, oligarket, krimin.

Mungesen e rregullave te qarta ne ligj, ne menyre qe te mos kete vend per keqinterpretime te punonjesve ne fushen e drejtesise te cilat kerkojne dokumente te panevojshme duke renduar qytetarin.

Mungesen e drejtesise.

Mungesa e njohurisë së përgjithshme ligjore.

Mundësia që gjithkush mund të ketë për tu aksesuar nëpërmjet internetit.


Burokracine

Mosfunksionimin e Gjykatave dhe vonesat ne reformen e drejtesise

Pyetja 4 dhe Nën-pyetja 4.1

4. Si e vlerësoni punën e bërë nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien?

11 responses



4.1 Ku mendoni se mund të përmirësohet transparenca? Cfarë shihni si sfidën më të madhe me transparencën në drejtësi aktualisht?

8 responses

nenen qe eshte gjetur kam nenat informacioni prej netj, me tabori, brenda parashikimeve ligjore.

Transparenca duhet rritur ne gjykata si dhe mbi situanten e zgjidhjeve alternative te mosmarreshjeve.

Ne cdo aspekt, sidomos me transparencen e punes se bere.

1. Publikimi i planeve të ndërmjetme dhe vjetore të punës.
2. Publikimi i emrave, pozicioneve kontakteve dhe kategorive të pagave të punonjësve civilë dhe zyrtarëve të lartë të institucionit.
3. Publikimi i informacionit institucional për planet dhe procedurat e prokurimeve publike (thirrjet, rezultatet, kontratat).
4. Publikimi i buxheteve vjetore faktike.
5. Publikimi i thirrjeve për konsultime publike, në webpage-in e institucionit.
6. Publikimi i raporteve për rezultatet e konsultimeve publike mbi draft-projektligjet e institucionit.
7. Publikimi i deklaratave të pasurisë së zyrtarëve të lartë të institucionit.

Çdo informacion duhet të publikohet.

Nën-Pyetja 4.2 dhe Pyetja 5

4.2 Ku mendoni se llogaridhënia mund të përmirësohet? Cfarë shihni si sfidën më të madhe me llogaridhënien në drejtësi aktualisht?

5 responses

-


Check and balanc!

Çdo mbledhje apo vendimarrje lidhje me komunitetin apo qytetarët duhet të jete publike dhe të jete transparente.

Funksionimin e sistemit te drejtesise.

5. A mendoni se ofrimi i Ndhmës Juridike Falas nga Ministria e Drejtësisë të jetë i mjaftueshëm për të siguruar që qytetarët të kenë akses në burimet ligjore?


11 responses



Pyetja 6 dhe Nën-Pyetja 6.1

6. Si e vlerësoni punën e bërë nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me sigurimin e ndërmjetësimit për çështjet juridike?

11 responses



6.1. Ku mund të përmirësohet ofrimi i medimit për çështjet juridike?

6 responses

Bashkpunim real me fakultetin e drejtësisë universiteti i tiranës!

Se pari, duhet të shpreh vërejtje mbi hartimin e këtij sondazhi. Besoj se në këtë pyetje fjala meditim është vendosur gabim. Mos ndoshta keni dashur të thoni ndërmjetësim?

Nuk kam informacion për të sugjeruar për përmirësim.

Sherbimet juridike falas, duhet të jenë sa më afër qytetarëve duke bërë meditim për problemet e e komunitetit në çdo fushë të saj.


-

Edhe ndërmjetësimi është mekanizëm i ndërruar nga ecuria e reformës në drejtësi. Duhet rritur ndërgjegjësimi i qytetarëve për ta përdorur si mekanizëm.

Pyetja 7 dhe Nën-Pyetja 7.1

7. A mendoni se Ministria e Drejtësisë i zgjidh çështjet e drejtësisë në mënyrë të drejtë?

9 responses



7.1. Ju lutemi shtjelloni më tepër

5 responses

Besoj qe ky pyetesor kerkon nje redaktim gjuhesor nga nje specialist i gjuhesise dhe te nje specialisti ne fushen e drejtesise. Gjithashtu sugjeroj qe tek alternativat te shtohet edhe nje tjetër: Nuk kam dijeni apo informacion.

Nuk kam informacion për të dhënë një opinion që të konsiderohet statistikiisht i rëndësishëm.

Mendoj se Ministria e Drejtësisë i zgjidh çështjet e drejtësisë në mënyrë të drejtë, sepse çdo çështje që ajo merr përsipër e zgjidh në mënyrë të pavarur dhe të saktë.


-

Nuk me duket plotesisht e pavarur ne menyren se funksionon. Mungon besimi i qytetareve dhe ekzistn nje perceptim se pas cdo Ministrie qendrojne vetem interesa te ngushta politike.

Pyetja 8 dhe 9


8. A mendoni se Ministria e Drejtësisë i zgjidh çështjet e drejtësisë në kohën e duhur?

10 responses



9. A mendoni se koha për të zgjidhur çështjet e drejtësisë dekurajon aksesin në drejtësi sipas opinionit tuaj?


11 responses



Pyetja 10 dhe Nën-Pyetja 10.1

10. Si e perceptoni punën e bërë nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me funksionimin e drejtë të institucioneve të varësisë, veçanërisht të Drejtorisë Burgjeve?

10 responses



10.1 A mendoni se ka ndonjë tematikë të veçantë që duhet adresuar?

5 responses

-

Instituti i mjeksise ligjore eshte per faqe te zeze. Drjtohet nga nje bandit.

Fokusimi te komunitetet e varfera.

Te drejtat e te denuarve me nevoja te veçanta apo te semure.

Nën Pyetja 10.2 dhe Pyetja 11

10.2 A mendoni se ka ndonjë zgjidhje të veçantë që duhet të konsiderohet për këtë temë?

4 responses


-

Kordinimi i puneve ne zgjidhjen e problemeve te qytetareve nepermjet pushtetit qendror, lokal dhe shoqerine civile.

Ngritja e Institucioneve te riedukimit per kategori te vecanta.

11. Si e perceptoni punën e bërë nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me funksionimin e drejtë të institucioneve të varësisë, si: Përmbaruesit ligjorë, Noterinë (licensimi, inspektimi dhe procesin e llogaridhënies)

10 responses



Nën-Pyetja 11.1 dhe 11.2

11.1 A mendoni se ka ndonjë tematikë të veçantë që duhet adresuar?

4 responses

Monitorimi i zbatimit të digjitalizimit noterial (realizimi i procedurave me barcode). Ka ende noterë që nuk punojnë me regjistrin online.

Shoqëria civile duhet të publikojë çdo vendim të Gjykatës, në mënyrë që të jetë transparente me qytetaret.

-

Rritja e kapaciteteve dhe profesionalizmit të permabruësve dhe notereve.

11.2 A mendoni se ka ndonjë zgjidhje të veçantë që duhet të konsiderohet për këtë temë?

4 responses

Kërkon njohuri më të thella në çështje, për të cilat informacionin aktual e kam të paktë.

Publikimi në rrjete sociale dhe Media.

-

Permirosimi i mekanizmave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Pyetja 12 dhe 13

12. Cilat fusha mendoni që Ministria e Drejtësisë mund të përmirësojë në punën e saj në mënyrë që të ndihmojë qytetarët të rrisin aksesin, transparencën dhe llogaridhënien?

4 responses

Kontrolle ne institucionet ne varsi!

Transparenca buxhetore dhe dhënia përgjigje në një kohë sa më të shkurtër pyetjeve dhe adresimeve të qytetarëve.

Pjesmarrja e Shoqerise Civile dhe Qytetareve ne vendimarrjet e pushtetit qendror dhe lokal.

Te pershtase sherbimet sipas nevojave dhe mundesive te qytetareve.

13. Ju lutemi, sugjeroni sipas opinionit tuaj, një ose disa masa prioritare që Ministria e Drejtësisë duhet të marrë në kontekst të aksesit të drejtësisë.

3 responses

Fushata informimi për qytetarët, edhe mbi progresin digjital të institucionet, gjë e cila ndihmon në shkurtimein e kohës së shpenzuar nëpër institucione, por edhe rrit cilësinë e marrjes së informacionit apo shërbimit.

Cdo sherbim ne lidhje me qytetaret duhet te behet publike.

Krijimi i mekanizmave me te thjeshte dhe me pak burokratik per te lehtesaur aksesin ne drejtesi te qytetareve.

Pyetja 14

14. Ju lutemi, jepni ndonjë koment ose sugjerim shtesë që mund të gjeni të lidhura me përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë

3 responses

E ezauruar në pyetjet e mësipërme.

Shoqëritë civile duhet të jenë përcues i mirë i sensibilizimit mes komunitetit dhe pushtetit vendor në mënyrë që të ketë efekt transparenca dhe llogaridhënia.

Duhet të ketë rritje të interesit të qytetarëve në lidhje me pjesëmarrjen gjatë seancave në gjykate që kanë lidhje me qytetarët.

Monitorimi i vendimeve nga Ministria e Drejtësisë nga Shoqëria Civile.

Pershpejtimi i reformës në drejtësi dhe mbajtja larg e politikës nga sistemi i drejtësisë.